



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 339 Dt. 10.05.2023
PRISHTINË • PRISTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit Arbitrar të FBK-së, Rregulloren Disiplinore të FBK-së, si dhe në bazë të Ankesës së z. Endrit Basha të datës 28.04.2023, Komisioni Arbitrar i FBK-së, me datë 10.05.2023 merr këtë:

VENDIM

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa z. Endrit Basha e datës 28.04.2023;
- II. APROVOHET PJESËRISHT Ankesa z. Endrit Basha e datës 28.04.202;
- III. NDRYSHOHET pika II e Vendimit të Komisionit Disiplinor i datës 25.04.2023.
- IV. SHQIPTOHET dënim me ndalesë për kryerje të të gjitha detyrave për të gjitha ndeshjet në kuadër të garave të FBK-së për periudhën kohore prej tetë (8) muaj për z. Endrit Basha, duke filluar nga data 05.04.2023.

ARSYETIM

Me datë 28.04.2023, Komisioni Arbitrar, përmes postës elektronike, ka pranuar Ankesën e z. Endrit Basha mbi Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 25.04.2023 (tash e tutje: "Ankesa").

Në këtë kuadër, Komisioni Arbitrar ka mbajtur takim më 08.05.2023 dhe ka trajtuar Ankesën. Në takim kanë qenë prezent: Korab Sejdiu (Kryetar i Komisionit Arbitrar), Lulzim Fushtica (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Fidan Hamiti (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së dhe Këshilltarja Ligjore për Sport e FBK-së.

Sipas kuptimit të Komisionit Arbitrar, z. Endrit Basha sfidon Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 25.04.2023, dhe pretendon se organi i shkallës së parë ka vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe ka shpërfillur dhe injoruar në tërësi rrethanat lehtësuese.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVES
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Lidhur me Ankesën, Komisioni Arbitrar ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsytet në vijim.

Fillimisht, Komisioni Arbitrar vlerëson se Komisioni Disiplinor ka vërtetuar korrekt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, në përputhje të plotë me udhëzimet e Komisionit Arbitrar në vendimin Nr. 252 të datës 13.04.2023.

Sa i përket pretendimit të z. Basha se Komisioni Disiplinor gabimisht ka vërtetuar për fyerje, provokim apo sulm ndaj gjyqtarëve, Komisioni Arbitrar konstaton se provat në dispozicion, me theks video incizimi dhe deklaratat e pranuar nga gjyqtarët, mjaftojnë për të vërtetuar se gjuha trupore dhe afërsia ndaj gjyqtarëve e z. Basha bien nën kuptimin e 'provokimit' sipas Nenit 65 të Rregullores Disiplinore të FBK-së.

Ndërkaq, rreth pretendimeve mbi pozitën zyrtare të z. Basha në KBF Peja 03, Komisioni Arbitrar konstaton se dokumentet e dorëzuara pranë FBK-së gëzojnë prioritet dhe nuk mund të shfuqizohen nga dokumente të tjera. Sipas Fletëparaqitjes për Edicionin 2022/2023 të dorëzuar nga KBF Peja 03 pranë FBK-së, Endrit Basha është i paraqitur si Drejtor i Klubit dhe rrjedhimisht mban pozitë zyrtare në klub. Për më shumë, Komisioni Disiplinor nuk ka përdorur pjesëmarrjen e z. Basha si ndihmës trajner në ndeshjen e Play-Off në mes KBF Peja 03 dhe WBC BASHKIMI si provë se z. Basha mban pozitë zyrtare në Klub, mirëpo ka përdorur këtë fakt për të paraqitur mos-përputhshmërinë mes deklaratës së z. Basha dërguar Komisionit Disiplinor, ku ky i fundit deklarohet se nuk mban 'asnjë pozitë zyrtare në klub aktualisht'. Rrjedhimisht, kjo është marrë si tentim për mashtrim para anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Së fundi, mbi sugjerimin se Komisioni Disiplinor gabimisht ka vërtetuar se z. Basha është recidivist dhe se kjo duhet të konsiderohet rrethanë rënduese, Komisioni Arbitrar përsërit arsyet e përmendura më lart.

Për më shumë, sa i përket aspektit të së drejtës materiale, Komisioni Arbitrar vlerëson se Komisioni Disiplinor ka përdorur bazën e duhur juridike duke u bazuar në Nenin 65 të Rregullores Disiplinor të FBK-së.

Së fundi, lidhur me pretendimin e z. Basha se organi i shkallës së parë ka shpërfillur dhe injoruar në tërësi rrethanat lehtësuese, Komisioni Arbitrar vlerëson se ky është i pabazuar, duke marrë parasysh se Komisioni Disiplinor ka adresuar si rrethanë lehtësuese kontributin dhe punën e z. Basha në basketbollin kosovar.

Përfundimisht, Komisioni Arbitrar vlerëson se arsyetimi i Komisionit Disiplinor sa i përket bazës juridike dhe rrethanave lehtësuese dhe rënduese ka qenë korrekt. Rrjedhimisht, ndryshohet vetëm pika II e Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 25.04.2023, dhe zbutet dënimi prej 18 muajve, kjo duke marrë parasysh parimin e proporcionalitetit mes shkëljes së bërë dhe shkallës së dënimit.

Prandaj, bazuar në Nenin 65 të Rregullores Disiplinore të FBK-së, i cili përcakton se *'kush fyen, provokon ose fizikisht sulmon garuesin, trajnerin, gjyqtarin, funksionarin, delegatin ose shikuesin në lojë, ose jashtë terrenit të basketbollit: do të dënohet më së paku 6 muaj me ndalesë loje apo kryerje të detyrës'*, z. Basha dënohet me 8 muaj ndalesë për kryerjen e të gjitha detyrave, për të gjitha ndeshjet në kuadër të garave të FBK-së.

Ky dënim hyn në fuqi pas ditës së përfundimit të dënimit paraprak ndaj z. Basha, gjegjësisht prej datës 05.04.2023.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Rrjedhimisht, duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, Komisioni Arbitrar vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Arbitrar:

Lulzim Fushtica

Prishtinë, 10 Maj 2023

Vendimi i dërgohet:

- Z. Endrit Basha (KBF Peja 03)
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor (si organ i shkallës së parë)
- Komisionit të Garave
- Anëtarëve të Komisionit Arbitrar
- Arkivit të FBK-së



KËSHILLË JURIDIKE:

Vendimet e arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit Arbitrar kanë të drejtë të ankesës te Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

